



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 365/25 Dt. 20.06.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 71684 datë 13.06.2025 të Visar Kolshit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 71684 datë 13.06.2025 të Visar Kolshit, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth transportit të 2 automjeteve me vlera të muzeut në kuadër të shënimit të edicionit të 20 -të të "Oldtimer Fest Prizren 2025", kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve rreth transportit të 2 automjeteve, përkatësisht të transportit të automjetit Flamuri i Kuq i vitit 1966 në relacionin Prizren -Tiranë dhe anasjelltas dhe automjetit Ford A i vitit 1923 në relacionin Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas, lejohen mjetet financiare në shumën prej 1000 € (njëmijë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shpenzime.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

